

Prof. Dr. Gëzim HOXHA

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
Instituti i Arkeologjisë
T I R A N E

JETSHKRIM I SHKURTER

Ka lindur në Shkodër me 7. 12. 1955. Ka mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës për Histori dhe Gjeografi në vitin 1981. Me pas është specializuar për arkeologji dhe që prej vitit 1983 deri më sot punon si arkeolog i Institutit të Arkeologjisë Tiranë.

Në vitin 1996 ka mbrojtur tezën e doktoraturës. Në vitin 2000 ka fituar titullin “Mjeshtër Kërkimesh”. Kurse në vitin 2009 ka fituar titullin Profesor.

Është anëtar themelues i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave (2011), dhe anëtar korespondent i Institutit Arkeologjik Gjerman (nga viti 2002).

Ai ka marrë pjesë dhe ka drejtuar një sërë ekspeditash arkeologjike të rëndësishmenë Shqipërinë e Veriut, në Kosovë dhe në Malin e Zi, duke i përqendruar kërkimet e tij kryesisht në arkeologjinë e provincës së antikitetit të vonë Praevalitana, në qytetet Shkodër dhe Lezhë .

Hoxha është autor i monografisë Scodra dhe Praevalis në Antikitetin e Vonë (2003), bashkautor i vëllimeve Fortifikime të shekujve IV-VI në Dardaninë Perëndimore (2003), Harta Arkeologjike e Kosovës Vell. I (2006) dhe Monumente historike të kultit të krishterë në dioqezën e Lezhës (2007).

Ka shkruar mbi 70 artikuj në revista shkencore, të botuara në Shqipëri, Gjermani, Francë, Itali dhe Austri. Është pjesëmarrës aktiv në mjaft Kongresse e Konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare për Arkeologjinë.

Jep leksione të specialitetit të vet në Universitetin e Tiranës. Ka mbajtur referate shkencore në Univeristtetet e Marburgut, Frankfurtit, Berlinit dhe Mynihut në Gjermani dhe në organizatën Patrimoine sans Frontieres në Paris. Kontributet e deritanishme dhe interesat e tij shkencore janë të përqendruara në temat mbi fortifikimet dhe materialin arkeologjik të periudhës antike të vonë, procesin e kristianizimit në provincat e Ilirikut Jugor dhe gjithashtu në topografinë historike të këtij rajoni.

Tiranë, me 08.10. 2016

Shënim:

Pothuajse të gjitha publikimet në versionin PDF mund të gjenden online në adresën:

[Gezim Hoxha academia.edu](http://GezimHoxha.academia.edu)